



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës e Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 04.03.2020

Të nderuar,

Ju falënderojmë për aplikimin tuaj për Programin Stipendium Hungaricum. Kemi kënaqësinë t'ju informojmë me rezultatet e raundit të dytë siç kërkohet në Rregulloren e Stipendium Hungaricum (Nominimet sipas shtetit). Në këtë raund të aplikimit (viti akademik 2020/2021) kemi pranuar 178 aplikime të suksesshme. Ne vlerësojmë shumë interesimin tuaj për programin.

Ju njoftojmë që kandidatët e propozuar do të vlerësohen nga Universiteti pritës dhe vendimi përfundimtar do të merret nga Bordi i Stipendium Hungaricum.

Komisioni i përzgjedhjes vlerësoi kërkesën tuaj duke përdorur kriteret e meritës akademike dhe të gjitha informacionet relevante të dhëna në formularin tuaj të aplikimit. Aplikimi u vlerësua në një shkallë deri 100 pikësh.

Në përgjithësi, parimet janë sipas renditjes vijuese të prioritetit:

1. Aplikacioni i plotësuar në internet, nota mesatare, dëshmi për njohjen e gjuhës (rezultatet më të larta), letër motivuese, letër rekomandimet, bazuar në marrëveshjen bilaterale në fuqi midis Hungarisë dhe partnerit dërgues (Kosovë), studime të plota. Përveç kësaj, për doktoraturë, vendimi i komisionit ka qenë i bazuar edhe në letrën e pranimit dhe deklaratën e nënshkruar të mbikëqyrësit. Vetëm deklaratat e nënshkruara të mbikëqyrësit (mentorit) janë pranuar.

2. Renditja sipas preferencës e programeve të zgjedhura të studimit në formularin e aplikimit.
3. Për shkak të konkurrencës së lartë, përparësi ju kemi dhënë aplikuesve me dokumente të kompletuara me të gjitha informacionet e ngarkuara tashmë brenda sistemit.

- Shënim:

Aplikuesit që nuk kanë ofruar ndonjë dokument siç përcaktohet në thirrjen e Stipendium Hungaricum dhe nuk kanë paraqitur një deklaratë të nënshkruar janë refuzuar.

Kandidatët të cilët kanë aplikuar në dy nivele studimi janë refuzuar .

Studentët të cilët nuk janë në listën e nominimeve ose rezervës, ne i inkurajojmë të aplikojnë për raundin e ardhshëm të aplikimit. Për shkak të bashkëpunimit të Stipendium Hungaricum, Ministria është përgjegjëse të sigurojë listën e nominimeve dhe nuk mund të marrë asnjë vendim pas afatit të nominimit. Ne jemi të hapur për të dhënë më shumë informacione, andaj afati për konsultim rreth rezultateve është 7 ditë kalendarike nga data e publikimit të listave (zyra 301, kati i tretë në MASHTI).

Informacion i rëndësishëm: Studentët e shkollave të mesme që aplikojnë për studime Bachelor duhet ti vendosin rezultatet e provimit të Maturës në sistemin online të Stipendium Hungaricum, sapo ti pranojnë ato. Në rast të dështimit në Provimin e Maturës, duhet të refuzojnë bursën dhe të njoftojnë MASHTI-in dhe Stipendium Hungaricum.

Aplikuesit e nominuar do të kontaktohen së shpejti nga Stipendium Hungaricum për vlerësime të mëtejme sipas Stipendium Hungaricum.

Ju lutemi gjeni bashkëngjitur në webfaqe listat për tri nivelet e studimit dhe detaje tjera.

Singerisht,

Komisioni vlerësues

